



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER
KOMISIONI I STREHIMIT**

Nr. 13353 Prot.

Fier më 21/11/2025

PROJEKT-VENDIM
Nr. 102 datë 21/11/2025

“Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit “Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” për vitin 2026.

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë ____/____/2025, i paraqitet për shqyrtim, materiali nga Komisioni i Strehimit, Bashkia Fier për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit “Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, si kërkesë ligjore për vazhdimin e procedurave administrativo-ligjore për përzgjedhjen e familjeve të pastreha të miratuara që kanë aplikuar për të përfutur nga ky program social strehimi.

Në zbatim të nenit 15, pika 1.1, neni 16 të Ligji Nr.22/2018 “Për strehimin social”; i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023 datë 22.06.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, neni 20 gërma “a” të aktit normativ VKM Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social, të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362, 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 69, datë 30.06.2023 “Për miratimin e Komisionit të Strehimit”, i ndryshuar me VKB nr. 115, datë 30.10.2023 neni 8 pika 1, 2, neni 9 pika 1.1/b, të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 54 gërma “k”

Propozon:

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për për programin social të strehimit” Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” për vitin 2026, sipas formatit tip:

	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25 pikë
A	Nuk disponon banesë në pronësi	6
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje.	4
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	4
Ç	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.	3
D	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve	3

	publike.	
E	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore	5
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25 pikë
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë , ku përfshihen edhe vajzat nëna	7
B	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për tu strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore	4
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë.	5
Ç	Familje të reja	5
D	Te rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	4
1.3	KUSHTET SOCIALE	25 pikë
A	Personat me aftësi të kufizuar sipas pikës 28 të nenit 2 të ligjit 22/2018 “Për strehimin social”.	3
B	Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore deri në moshën 30 vjeç	2
C	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish- pronarëve	1
Ç	Emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrant, dhe azilkërkuesit, refugjatet apo personat me mbrojtje plotësuese në kuptim të legjislacionit përkatës.	2
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë	2
DH	Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë(FNSH), punonjës të repartit RENE A, Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.	1
E	punonjës të repartit RENE A	1
ë	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.	1
F	Viktimat e trafikimit, viktimat e mundshme të trafikimit	2
G	Anëtar i minoritetit rom	2
GJ	Anëtar i minoritetit Egjiptian	2
H	I mitur në konflikt me ligjin sipas kodit të Drejtësisë Penale për të mitur	2
I	Komuniteti LGBTI	1
J	Vajzat nëna	3
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25 pikë
A	Familje pa të ardhura	10
B	Të ardhura deri në 70% të të ardhurave mesatare	7
C	Të ardhura deri 70% – 100% të të ardhurave mesatare	5

Në llogaritjen e pikëve për familjet përfituese, Komisioni i Strehimit duhet të marrë në konsideratë rregullat e mëposhtme:

I. Pikët maksimale që mund të përfitojë një familje janë 100. Nuk mund të mblidhen brenda për brenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në E të kriterit 1.1 “Kushtet e strehimit”
2. Nga A deri në D të kriterit 1.2 “Kushtet familjare”
3. Nga A deri në C të kriterit 1.4 “Kushtet ekonomike”

II. Piket nga A deri në I të kriterit 1.3 “Kushtet Sociale” mund të mblidhen me njëra tjetrën sipas rasteve më poshtë:

1. Pika A mund të mblidhet me njërin sipas rasteve si më poshtë:

- a)-me pikat B dhe D së bashku ose veçmas
- b)-vetëm me pikën Ç
- c)-vetëm me pikën E

2. Pika B mund të mblidhet vetëm me pikën A

3. Pika Ç mund të mblidhet vetëm me pikën A

4. Pika D mund të mblidhet me pikat A dhe B së bashku ose veçmas. Në total mbledhja e pikave A, B, D nuk duhet të rezultojë më e madhe se 25 pikë.

2. Ngarkohet Komisioni i Strehimit, Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi Nr. 143, datë 23.12.2024 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet sociale të strehimit “Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij për vitin 2025, shfuqizohet.

Komisioni i Strehimit

Pranvera Çina

Denisa Azizaj

Melsi Bogdani

Themion Mile

Endri Jaupaj

Kreshnik Dapi

Rrapi Gjika

Elvi Daka

Natasha Sollaku

Konceptoi:

N. Sollaku

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ZV.KRYETARË E BASHKISË
MIRELA PITUSHI